



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/03-39481/19
Kaçanik, 23. 12.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XII** (Dymbëdhjetë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VI e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23 Dhjetor 2019. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve sa ka KPF, pjesëmarrës në mbledhje ishin të gjithë anëtarët: Kemal Mërseli, Nexhat Loku, Pranverë Loku-Zharku, Ekrem Kyçyku, Selim Reka, Hafize Sallahi dhe Albana Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë; Kryetari i Komunës –Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive; Festim Neziraj, Ramadush Osmani dhe Fatmir Loku.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit Kemal Mërseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e XII-të (Dymbëdhjetë) të Rregullt të KPF-a, data 23 Dhjetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-a;
2. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020;
3. Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023;
4. Raporti Nëntë Muor Financiar, për periudhën: Janar – Shtator 2019;
5. Propozim Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU “ Bifurkacioni” nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore; dhe
6. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës.

Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit ishte njëzëri me punuar me këtë rend pune. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e,

APROVOJ

Rendin e propozuar të punës, në përbërje 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas rendit të punës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhës së XI-të (Njëmbëdhjetë) të Rregullt të KPF-a, mbajtur me datë 25 Nëntor 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-36794/19.

2. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, Plani është hartuar nga komisioni i KK. Ky Plan është orientues dhe mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas çështjeve dhe nevojave që na paraqiten. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Propozoj të futet në Plan pune këto çështje: Raporti i auditimit të brendshëm; Çështja e matjes akustike të zhurmës nëpër lokale të Komunës; dhe Informatë e Zyrës së Prokurimit për vitin 2019.

Kryesuesi i Kuvendit, Çështja e matjes akustike të zhurmës mund të shtohet të pika, Informatë për zbatimin e ligjit kundër duhanit, ndërkaq Raporti i auditimit është përfshirë të mbledhja e 2-të. Edhe Informata e Zyrës së Prokurimit për aktivitetin e zhvilluar në për vitin 2019, është të mbledhja e 12. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020 dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Plani i Veprimit për Transparencë 2020-2023 dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Raporti Nëntë Muor Financiar, për periudhën: Janar – Shtator 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë raport, fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Kërkoj falje që Raporti financiar iu është ofruar me vonesë për shkak të disa angazhimeve të tjera të cilat i pata, si çështja e angazhimit tim në fushatë për deputet të Kuvendit të Kosovës dhe disa çështje familjare.

Raporti i paraqet detajet edhe në formë tabelare për të gjitha mjetet buxhetore dhe shpenzimin e tyre. Shpenzimet për 9 muaj janë 60.24%, e që kujtoj së është i kënaqshëm ky shpenzim për periudhën 9-të mujore. Në vazhdim drejtori Selimi i dha me shifra indeksin e shpenzimeve në raport me vitin e kaluar, aty ku ka pasur ngritje apo ulje, paraqitura si në tabela të këtij raporti. Trende të mira kanë pasur shpenzimet të Investimeve Kapitale, ndërkaq ngecje ka pasur pak, Subvencionet dhe transferet dhe të Mallrat dhe Shërbimet. Të subvencionet janë përkrahur, Aktivitetet kulturore, Bujqësia dhe Shërbimet sociale.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Si po shihet, pjesa dërmuese e buxhetit është nga Granti qeveritar, ndërkaq të HVK nuk janë realizuar ashtu si janë planifikuar, në disa sektor, si të DAP, realizimi i të hyrave është i vogël të certifikatat, si ato të kurorëzimit dhe certifikata të tjera. Të alokimi i mjeteve, të disa drejtori alokimet janë mirë, ndërkaq shpenzimet nuk janë realizuar aq sa janë alokuar. Të subvencionet dhe transferet, nuk është realizuar shpenzimi i tyre 100% ashtu si janë planifikuar. Të DAK subvencionet janë ndarë në formë jo të drejtë. Këtë e themi sepse janë subvencionuar më tepër SHKA që nuk kanë zhvilluar ndonjë aktivitet në raport me SHKA që kanë zhvilluar aktivitete brenda dhe jashtë vendit.

z. Selim Reka, Raporti si raport është mirë i hartuar, ndërkaq nëse hyjmë në analiza shihet së të HVK janë mirë të tatimi në pronë, shpresoj që ky aktivitet të vazhdoj edhe tutje. Të taksat për ushtrimin e veprimtarisë, të inspektorati, shihet se gjobat kemi tejkalim të inkasimit, kjo është për t'u përshëndetur. Të shpenzimet e realizuara, dinamika e shpenzimeve është e vogël në raport me buxhetin. Ulje të realizimit të shpenzimeve kemi të Mallrat dhe Shërbimet, ndërkaq të Investimet Kapitale shihet së kemi ngritje të shpenzimeve, megjithëse edhe në këtë pozicion jemi pak prapa karshi objektivave. Dinamika e realizimit të shpenzimeve nuk ka shkuar në raport me alokimin, sepse janë alokuar mjete, ndërkaq nuk janë shpenzuar aq sa janë alokuar. Të shpenzimet komunale nga raporti shihet së kemi ulje të shpenzimeve të mbeturinat dhe të telefonia, ndërkaq ngritje të shpenzimeve kemi të shpenzimet e energjisë elektrike. Këtu duhet bërë një studim pse ka ardhur deri të kjo ngritje e shpenzimeve në këtë pozicion.

z. Bahri Selimi, Të HVK kemi tejkalim të hyrave të taksa për ushtrimin e veprimtarisë, kjo për arsye se nuk kanë mundur me i regjistruar biznese pa paguar se paku 50% të borgjit. Të Investimet Kapitale, natyra e punëve është e tillë që nuk po mundemi me punuar në çdo kohë, si në kohën e reshjeve atmosferike etj. Të Subvencionet dhe transferet, të DAK, shumica e subvencioneve janë ndarë me shpallje publike. Në vazhdim drejtori dha edhe sqarime të tjera lidhur me të hyrat dhe shpenzimet në të gjitha programet shpenzuese buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë raporti nuk votohet, kështu që KK i shkon në formë informate. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e, e shqyrtoj **Raportin Nëntë Mujor Financiar, për periudhën: Janar – Shtator 2019; dhe i njëjti i kalohet në procedurë të shqyrtimit Kuvendit të Komunës në formë të informate.**

5. Propozim Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU “ Bifurkacioni” nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, lëndës iu ka bashkangjitur edhe një Vendim i qeverisë. Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani, Bazë për marrjen e këtij Vendimi është Vendimi i Këshillit ministror. Kërkesa ka qenë e mëhershme edhe nga dy komunat: Hani i Elezit dhe Shtërpçës. Me Ligjin për Ndërmarrje Publike, Ndërmarrja “Bifurkacioni” kalon në nivel qendror. Është kërkuar të fillohet me këtë proces nga MEF, ku nga komuna jonë kam qenë unë, ndërkaq e kam përkrahur këtë iniciativë, sepse na hapen dyert për investime nga donacionet përmes ndërmarrjes në nivel qendror. Pasi të miratohet ndryshimi i statusit të ndërmarrjes, ndërmarrja do të fillojë me ndryshimin e Statutit, i cili statut do të ndryshohet dhe plotësohet nga Bordi i ndërmarrjes. Borgjet të cilat i ka ndërmarrja do t’i shkojnë KRU “Bifurkacionit”. Struktura organizative nuk ndryshon, ashtu që Komuna e Kaçanikut do të ketë Njësinë e vet me të drejta të barabarta me njësitë tjera të ndërmarrjes.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Në Propozim Vendim shënohet ndryshimi i statusit të ndërmarrjes nga ndërmarrja lokale në ndërmarrje qendrore. Mos është bërë ndonjë gabim këtu, ndoshta duhet të jetë ndryshimi i statusit të ndërmarrjes nga regjionale në ndërmarrje qendrore. Shqetësimet e mia janë së me këto ndryshime të statusit të ndërmarrjes, mund të ndodhë që komuna jonë të paguajë tarifën si në Prishtinë, ndërkaq komuna jonë, ujin e pijes e kemi me rënie të lirë, ndërkaq komuna jonë sa herë ka paguar njëjtë tarifën me Komunën e Ferizajt.

Kryesuesi i Kuvendit, Me ndryshimet të cilat do të bëhen a do të hynë në sistem të ujësjellësit të gjitha komunitetet.

z. Ramadush Osmani, Në sistemin e ujësjellësit do të futën edhe të gjitha ujësjellësit e komuniteteve dhe të njëjtat do të kontrollohen e menaxhohen dhe mbikëqyrën nga ndërmarrja, sepse është në pyetje shëndeti i njeriut.

znj. Hafize Sallahi, Fshati Biçec nuk dëgjojnë me futur në menaxhim ujin e pijes, por të njëjtin e mbikëqyrë Këshilli i fshatit. Edhe unë unë e përkrahi Propozim Vendimin për ndryshimin e statusit të ndërmarrjes, ndërkaq kërkoj të hynë në menaxhim të ndërmarrjes të gjitha rrjetet e ujësjellësit të komuniteteve dhe të njëjtat të bëhen me pagesë.

z. Selim Reka, Edhe unë e përkrahi ndryshimin e statusit të ndërmarrjes, me shpresë që do të kemi investime më shumë sesa me kompaninë regjionale të Ferizajt dhe besoj se nuk do të jetë faktor dominues më Ferizaj tani e tutje, por të jemi njësi komunale me të drejta të barabarta në këtë ndërmarrje.

z. Ramadush Osmani, Nuk ka më asnjë njësi e cila do të jetë dominuese. Të gjitha njësitë do të jenë më status të barabartë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin për ndryshimin e Statusit të ndërmarrjes KRU "Bifurkacioni" e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF, e

Aprovoj

Propozim Vendimi për Ndryshimin e Statusit aktual të KRU " Bifurkacioni" nga Ndërmarrja publike lokale në Ndërmarrje publike qendrore; dhe e njëjta i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Unë jam me e përkrahur Propozim Vendimin që drutë e konfiskuara me iu ndarë shkollave të komunës. Një diçka që nuk e kam të qartë është, numri i druve të konfiskuara është shumë i vogël në raport me shkatërrimin e pyjeve, kur dihet së pyjet e komunës dita ditës po shkatërrohen.

z. Ekrem Kyçyku, Sasia e druve të konfiskuara të shënohet në dispozitiv të vendimit e jo në arsyetim.

Kryesuesi i Kuvendit, Propozim Vendimi të shkon kështu në KK, ndërkaq në Vendim kjo të rregullohet, ashtu që sasia e druve të konfiskuara të shënohet në dispozitiv të vendimit. Atëherë, meqë nuk ka kush diçka tjetër, a jeni të pajtimit që ky Propozim Vendim t'i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë për shqyrtim dhe Aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës; dhe i njëjti i,

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, Mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:45. Mbledhja e Kuvendit të Komunës është caktuar për datë, 27 Dhjetor 2019 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli
Kemal Mërseli

